



KUJDESI SHËNDETËSOR NË BANESË



Kujdesi Shëndetësor në Banesë (KSHB) është një shërbim i ri i kujdesit shëndetësor parësor, që ofrohet në shtëpi, kryesisht nga infermieret, për pacientët kronikë të invalidizuar që nuk mund të paraqiten fizikisht në qendrat shëndetësore. Ky shërbim synon të përmirësojë cilësinë e jetës, të reduktojë komplikacionet dhe të shmangë hospitalizimet e panevojshme.

KONTEKSTI DHE NEVOJA

- Përlllogaritet në rreth **15,000** numri i të sëmurëve që nuk mund të aksesojnë qendrat shëndetësore.
- Rreth 20% e popullsisë shqiptare është mbi 65 vjeç.
- Kërkesa për kujdes afatgjatë dhe të integruar është në rritje.

Pasoja në sistem: Presion i lartë mbi shërbimet spitalore dhe kujdesin shëndetësor parësor tradicional dhe kosto të larta për familjet e pacientëve.

OBJEKTIVI I SHËRBIMIT

- **Vlerësimi i të sëmurëve** dhe planifikimi i shërbimeve në banesë në varësi të nevojave të tyre;
- **Sigurimi i kujdesit të vazhdueshëm** dhe të aksesueshëm në komunitet;
- **Ruajtja e autonomisë funksionale** të pacientëve;
- **Ulja e kostove direkte dhe indirekte** për pacientët dhe sistemin shëndetësor.

PËRFITUESIT KRYESORË

- ✓ **Pacientë kronikë të invalidizuar** me sëmundje kronike, sëmundje terminale dhe çrregullime të shëndetit mendor.
- ✓ **Pacientë post-spitalorë** në nevojë për kujdes pas ndërhyrjeve kirurgjikale.
- ✓ **Persona me aftësi të kufizuara**, tetraplegjikë, persona me dëmtime të rënda funksionale etj.
- ✓ **Të moshuar të invalidizuar** për shkak të moshimit.

SFIDAT E ZBATIMIT DHE TË SHTRIRJES SË SHËRBIMIT

- ✓ **Kapacitete të kufizuara institucionale**, veçanërisht në nivel vendor, për monitorimin efektiv të shërbimit dhe edukimin në vazhdim të infermiereve.
- ✓ **Mungesë e burimeve financiare dhe logjistike** për qendrat shëndetësore, përfshirë mbulimin e kostove të transportit, furnizimin me barna esenciale dhe materiale konsumi.
- ✓ **Rezistencë nga stafi shëndetësor**, e lidhur me mungesën e stimujve financiarë, mjeteve të punës dhe mbështetjes operationale.
- ✓ **Sistemet e dobëta të raportimit të të dhënave**, përfshirë mbi-raportimin dhe mungesën e ndarjes së qartë të kategorive të përfituesve, që ndikojnë në transparencë dhe planifikim.
- ✓ **Mungesë e një kuadri strategjik të përditësuar** për periudhën pas vitit 2025, që rrezikon qëndrueshmërinë dhe institucionalizimin e shërbimit.

HISTORIKU I ZBATIMIT TË SHËRBIMIT NDËR VITE

Viti	2021	2022	2023	2024	2025	Total
Nr. i Qendrave Shëndetësore të mbështetura nga HAP	9	22	27	62	30	150
Nr. i infermiereve të trajnuara për KSHB-në	97	275	218	248	250	1088



KUJDESI SHËNDETËSOR NË BANESË

KONTRIBUTI I PROJEKTIT HAP

- ✓ **Risite kyçe:**
 - **Konceptimi dhe ofrimi i një shërbimi të ri** shëndetësor për grupe vulnerabël që nuk merrnin shërbime shëndetësore përpara kësaj ndërhyrjeje.
 - **Rritja e autonomisë profesionale** të infermieres.
 - **Ngritja e Programit të Masterit** Profesional në Infermieri Familjeje (2021-)
- ✓ **Zhvillimi i kapaciteteve**
 - **1,088** infermierë të trajnuar për kujdes në banesë
 - **137** profesionistë të trajnuar për monitorimin e shërbimit
- ✓ **Standardizimi i procedurave dhe hartimi i udhëzuesve**
 - Manuali për Zbatimin e Kujdesit Shëndetësor në Banesë
 - Manuali i procedurave standarde infermiore
 - Manualët e monitorimit të zbatimit të KSHB-së (të brendshëm dhe të jashtëm)
 - Manuali për përdorimin e instrumenteve mjekësore të konsultës infermiore
- ✓ **Furnizim me pajisje**
 - **208** Qendra Shëndetësore të pajisura me mjete mjekësore/paramjekësore
 - **677** pajisje TIK (desktopë/laptopë/printer) për stafin dhe institucionet

REZULTATET KRYESORE

SHTRIRJA DHE SHËRBIMI I OFRUAR

- Kujdesi Shëndetësor në Banesë aktualisht ofrohet në **150** Qendra Shëndetësore në **20** Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
- Mbi **5,134 pacientë** kronikë dhe të moshuar kanë përfituar kujdes të vazhdueshëm dhe të personalizuar në banesë. Nuk dihet me saktësi se sa prej tyre i përkasin kategorisë së pacientëve në pamundësi lëvizjeje.
- Sipas të dhënave të FSDKSH-së, në periudhën 2021-2025, janë realizuar **146,236 vizita** në banesë, duke reduktuar nevojën për hospitalizime dhe akses fizik ndaj shërbimeve.
- **1,088 infermiere** të trajnuara kanë përmirësuar kapacitetet e sistemit për ofrimin e një kujdesi komunitar më cilësor.

VLERA E SHTUAR PËR SISTEMIN SHËNDETËSOR

- **Shërbim i ri** që ofron kujdes për kategoritë më vulnerabël të pacientëve
- Kalim drejt një **modeli shërbimi proaktiv** dhe komunitar (parandalon, këshillon, trajton në kohë).
- **Fuqizim i rolit të infermieres** përmes rritjes së autonomisë dhe përgjegjësiive profesionale.
- **Rritje e eficiencës** së sistemit shëndetësor

REZULTATET E SHËRBIMIT PËR PERIUDHËN 2021-2025

Viti	2021	2022	2023	2024	2025	Total
Nr. i pacientëve përfitues	260	592	1486	4178	5134	5134
Nr. i vizitave të kryera	1548	3240	8937	43925	88586	146236

